



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 27 qershor 2014  
Nr.ref.:RK651/14

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI199/13**

Parashtrues

**Sinan Rashica**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 331/2011, të 11 janarit 2013**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Sinan Rashica, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin Rev. nr. 331/2011, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), Rev. nr. 331/2011, të 11 janarit 2013, i cili i është dorëzuar atij në një datë të pacaktuar.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet *"t'ia ketë mohuar të drejtën e punës - neni 49 i Kushtetutës"*.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 13 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI199/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI199/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 5 mars 2013, Gjykata Supreme ishte njoftuar për kërkesën.
8. Më 20 maj 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Më 13 shkurt 2004, Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK), e aprovoi kërkesën e parashtruesit për pension në kategorinë "A" (Nr. 43/16) në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 dhe me Statutin e Fondit Pensional të KEK-ut.
10. Në vendimin e lartcekur të KEK-ut ishte përcaktuar se pagesa e pensionit për parashtruesin e kërkesës do të fillojë më 1 shkurt 2004 dhe do të përfundojë më 29 shkurt 2009, derisa shuma e pensionit mujor do të jetë 105 euro. Për më tepër, vendimi theksonte se pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh Komisionit për shqyrtimin e kontesteve, përmes Administratës së Fondit Pensional.
11. Sipas dokumenteve të dorëzuara, nuk është paraqitur asnjë ankesë kundër këtij vendimi.

12. Pas 29 shkurtit 2009, KEK-u e ndërpreu pagesën e pensionit të parashtruesit të kërkesës, siç ishte specifikuar në marrëveshje.
13. Parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
14. Më 21 shkurt 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 362/2009) e aprovoi padinë e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës dhe e urdhëroi KEK-un të vazhdojë me pagesë deri në themelimin e Fondit Pensional Invalidor të Kosovës.
15. KEK-u ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale (Aktgjykimi C. nr. 362/2009).
16. Më 28 qershor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi Ac. nr. 497/2011) e refuzoi si të pabazuar ankesën e dorëzuar nga KEK-u dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale.
17. Më 20 mars 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi E. nr. 2139/11) urdhëroi përmbarimin e vendimit (Aktgjykimi C. nr. 362/2009).
18. Më 4 prill 2012, KEK-u ushtroi ankesë kundër aktvendimit të lartcekur dhe kërkoi që procedura përmbarimore të pezullohet deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Supreme të Kosovës.
19. Më 12 prill 2013, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi E. nr. 2139/11) e hodhi poshtë kërkesën për pezullimin e procedurës përmbarimore.
20. Më 10 gusht 2011, KEK-u dorëzoi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
21. Më 11 janar 2013, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev. nr. 331/2011) e aprovoi revizionin e ushtruar nga KEK-u.
22. Gjykata Supreme konstatoi se:

*“Gjykatat e instancës më të ulët drejtë dhe në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike por, gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar. Nga vendimi nr. 43/16 nga data 13.02.2004, del se paditësi vetë ka aplikuar për fitimin e pensionit në emër të kategorisë I, invaliditetit në punës në pajtim me Rregulloren e UNMIKU-ut nr. 2001/35 dhe Statutit të Fondit Pensional të KEK-ut e cila kërkesë i është miratuar nga ana e të paditurës dhe sipas këtij vendimi pagesa e pensionit ka filluar prej datës 01.02.2004 dhe përfundon më 29.02.2009, në lartësi prej 105 € në muaj. Paditësi ka mund të paraqes ankesë kundër këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit Komitetit për shqyrtimin e mospajtimeve përmes administratës së Fondit Pensional, por ankesë nuk ka ushtruar dhe pensionin e ka pranuar gjer më 29.02.2009. Kjo Gjykatë vlerëson se pas pagesës së pagës në afatin e paraparë në vendim, e paditura më tutje nuk ka obligim ndaj paditësit, ngase ka përmbushë obligimin ligjor i cili rrjedh nga vendimi i cekur”.*

23. Më 14 qershor 2013, Gjykata e Apelit e refuzoi si të pabazuar ankesën e ushtruar nga KEK-u dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale (E. nr. 2139/11, të 12 prillit 2012).

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës *“ia mohon të drejtën sipas nenit 49 të Kushtetutës për kompensim të përkohshëm të të ardhurave personale. Kjo e drejtë më është njohur me Aktgjykimin C. nr. 362/2008 të 21.02.2011 dhe Aktgjykimin Ac. nr. 497/2011 të 28.06.2011”*.
25. Parashtruesi i kërkesës thekson më tej se: *“arsyeja pse ai e nënshkroi dhe nuk ushtroi ankesë ndaj vendimit të KEK-ut ishte sepse KEK-u kishte premtuar se ose do të vazhdohej ose ata do të ktheheshin në punë”*.
26. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Kushtetuese *“t’ia njohë të drejtën për kompensim të përkohshëm deri në funksionimin e fondit pensional invalidor në Kosovë”*.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

27. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
28. Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:
- “Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)”*.
29. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili përcakton se:
- “(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
- ...  
b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi...”*
30. Në këto rrethana, Gjykata vëren se aktgjykimi i kontestuar nga parashtruesi i kërkesës është i 11 janarit 2013 dhe vendimi i fundit është i 14 qershorit 2013, ndërsa kërkesa është paraqitur më 13 nëntor 2013. Kërkesa e parashtruesit nuk është në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës pasi që ishte dorëzuar më shumë se 1 (një) muaj pas vendimit të kontestuar.
31. Gjykata përkujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, është të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme si dhe vendimet e kaluara të mos

jenë vazhdimisht të hapura për kontestim (shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi i 25 gushtit 2005).

32. Për më tepër, duke iu referuar rasteve të gjykuara nga Gjykata në lidhje me kompensim të përkohshëm për ndërprerje të punës nga ana e KEK-ut, Gjykata konsideron se në bazë të dokumenteve të paraqitura dhe procedurave të përfunduara, kjo kërkesë ndryshon nga rastet e lartcekura, pasi që marrëveshja e nënshkruar në mes të KEK-ut dhe ish-punëtorëve të tjerë të KEK-ut ka qenë deri në themelimin e Fondit Pensional Invalidor të Kosovës pa asnjë referencë të një date të përfundimit përkitazi me kërkesën e tanishme.
33. Nga kjo rrjedh se kërkesa e parashtruesit është e paafatshme.


### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit, rregullat 36 (1) b dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 20 maj 2014, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Dr. sc. Kadri Kryeziu



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

  
Prof. dr. Enver Hasani